

5.03.2022

Ora 15:38

**RENDI I DITËS**


Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 6,  
dt.5.03.2022, subjekti ankues Partia Demokratike”.

**PJESËMARRJA :**

- KAS:
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema

*Z. Y. Merkaj:* Përshëndetje të gjithëve, sot në datën 5.03.2022, po zhvillojmë procedurën për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 6, të paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në orën 15:00. Ankues është Partia Demokratike me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.128, dt.5.03.2022, “Për shqyrtimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit të njësive administrative: Pult, Shosh dhe Shalë”. Procedura e shortit si edhe më parë, do të zhvillohet sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur pesë shirita letre të bardhë, në një të një prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 6, katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Shiritat palosen dhe vendosen në pesë gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, e më pas vendosen në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kjo procedurë do të zhvillohet pa praninë e anëtarëve të KAS-it. Pasi janë palosur të pestë shiritat e letrës, janë vendosur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në enën transparente, një përfaqësues i KQZ-së i përzier

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.03.2022*

dhe tërheq duke filluar nga rendi alfabetik rritës i anëtarit të KAS-it. Fillojmë procedurën.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.


Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Kërkesa Ankimore nr.6.  
Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilir Rusmali – shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit, relator i Kërkesës Ankimore nr. 6, do të jetë zoti Elvis Çefa, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 6, ardhur në KQZ në datën 5.03.2022, subjekti ankues Partia Demokratike”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Ledio Braho, Z. Koli Bele (on-line)
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** PD (M. Logu)

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve, çelim seancën për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 6, datë 5 mars 2022, të paraqitur para KAS-it nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, kundër vendimit nr. 128, datë 5.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me anë të të cilit është miratuar ndryshimi i disa qendrave të votimit në Shkodër, që i takojnë zgjedhjeve të datës 6 Mars 2022 që janë në Bashkinë Shkodër. Në cilësinë e relatorit do të jem unë, Elvis Çefa. Është paraqitur përfaqësuesi i akredituar i Partisë Demokratike, avokati Logu, gjithashtu prezent është administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Ndonjë kërkesë paraprake për konflikt interesi për ndonjë përjashtim nga trupa e KAS-it? Avokat? Nuk ka! Kolegë, ndonjë deklaram për konflikt interesi? Nuk ka! Ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të na relatojë shkurtimisht lidhur me vendimmarrjen e Komisionerit dhe pretendimet e subjektit ankimues, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 128, datë 5.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në njësitë administrative: Pult, Shalë dhe Shosh në Bashkinë Shkodër. Kërkesa është e ripërsëritur dhe ka reflektuar ndryshimet, ose ka reflektuar nga vendimi i parë i Komisionerit i cili ka rrëzuar kërkesën e Bashkisë Shkodër dhe ka kërkuar që qendrat e votimit në këto njësi administrative të ndryshohen duke caktuar edhe qendrat e votimit me adresa të sakta ku do të vendosen qendrat e votimit. Kjo, me arësyetimin se kërkesa e Bashkisë Shkodër, pjesërisht bazohet në Kodin Zgjedhor dhe konkretisht në nenin 93, pika 3, pasi disa kërkesa janë propozuar në ambjente të cilat nuk janë në zonën e qendrës së votimit, por janë në zonën e qendrës së votimit fqinjë. Me këtë arësyetim ka miratuar pjesërisht kërkesën e Bashkisë Shkodër, duke i zhvendosur vendndodhjen e qendrës së votimit 116, 117, 118, 119 dhe 119/1, dmth pesë qendra votimi, nga njësitë administrative Bregu i Lumit, Fshati Lekaj, në Fshatin Theth brenda të njejtës njësi administrative. Shtatë kërkesat e tjera i ka rrëzuar. Ky është arësyetimi i Komisionerit në vija të përgjithshme, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit! Lidhur me elementët formalë të kërkesës, shoh që me gjithë afatin e shkurtër është plotësuar formulari i ankimit. Sigurisht që kërkesa është brenda afatit. Kolegët, ndonjë pyetje sqaruese ndaj ankimesit, lidhur gjithmonë me këtë fazë të procesit. Po zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Kisha pyetje ndaj KQZ-së në fakt, sepse ankimesi ende nuk ka folur. Për administratën. Baza ligjore për këtë kërkesë që ka bërë Bashkia Shkodër është sërish pjesa e forcës madhore, apo..?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Po, po, neni 62, pika 4 dhe neni 93, pika 2 dhe 3.

**Z. L. Braho:** Po vendimi i Komisionerit për sa zbardhet?

**Z. Y. Merkaj:** Duhet të jetë në zyrën e komisionerit, besoj çështje minutash.

**Z. L. Braho:** Me sa dëgjova në mbledhje unë, u fol për ambiente në pronësi të simpatizantëve të Partisë Socialiste...

**Z. Y. Merkaj:** Jo, jo ishte e Bashkisë Durrës ajo, jo, jo!

**Z. L. Braho:** Aha, dakord!


**Z. E. Çefa:** Avokat, keni diçka për të shtuar, në këtë fazë gjithmonë?!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Duke qenë se jemi në seancë paraprake, thjesht mendoj që kërkesa duhet të kalojë për shqyrtim në seancë, sepse përmbush të gjitha kërkesat që kërkohen nga Kodi Zgjedhor, për sa i përket aspekteve formale të saj. Për pjesën e themelit, besoj se do të kemi mundësinë të ndalemi më tej. Në qoftë se ka ndonjë pyetje nga ana e anëtarëve jam i hapur.

**Z. E. Çefa:** Kolegë, pyetje?

**Z. I. Rusmali:** Vetëm një pyetje. Ju si subjekt, keni marrë pjesë në seancën e shqyrtimit administrativ nga komisioneri?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Rusmali! Kemi marrë pjesë dhe të gjitha arësyet që ne kemi parashtruar në ankim, i janë parashtruar edhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Z. E. Çefa:** Dakord, atëherë KAS-i i konsultuar në vend, vendosi: Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë, e cila do të zhvillohet sigurisht sot për shkak të karakterit emergjent që ka çështja. Zoti Sekretar i Përgjithshëm, kur mund ta kemi në dispozicion vendimin e zbardhur, në mënyrë që të procedojmë edhe me orën e seancës?

**Z. Y. Merkaj:** Besoj në orën 16:30.

**Z. E. Çefa:** Dakord, meqenëse dhe kolegu Bele ka kërkuar pak kohë që dhe ai të jetë prezent, e lemë në orën 17:00?

*(diskutime pa mikrofon ndërmjet anëtarëve të KAS-it)*

**Z. E. Çefa:** Dakord atëherë, seanca do të zhvillohet në orën 16:30, sot në datën 5 mars 2022, faleminderit!

**Vendimi nr. 12**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**


**Projektvendim “Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 6, ardhur në KOZ në datën 5.03.2022, subjekti ankues Partia Demokratike”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Ledio Braho, Z. Koli Bele (on-line)
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** PD (M. Logu)

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve, fillojmë seancën e shqyrtimit në themel të Kërkesës Ankimore nr. 6, datë 5 mars 2022, të paraqitur para KAS-it nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 128, datë 5.03.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me anë të të cilit është pranuar pjesërisht kërkesa e Bashkisë Shkodër dhe është dhënë autorizimi për ndryshimin e disa qendrave të votimit në këtë bashki. Verifikojmë prezencën! Janë prezent anëtarët e KAS-it, për arsye objektive, kolegu Koli Bele do ta ndjekë këtë seancë on-line dhe do të jetë këtu me ne gjatë gjithë kohës. Është prezent, përfaqësuesi i akredituar i palës ankimuese, avokati Marash Logu. Gjithashtu prezent është administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Fillojmë menjëherë këtë seancë, meqenëse verifikimet paraprake i ezauruam tashmë në seancën e shqyrtimit paraprak të kërkesës. I jap menjëherë fjalën avokatit të palës ankimuese, zotit Logu, për të na parashtruar shkurtimisht rrethanat, faktet dhe arsyet për të cilat ky subjekt zgjedhor nuk është dakord me vendimin e Komisionerit. Zoti avokat!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.05.03.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Çefa! Ditën e djeshme Partia Demokratike është njohur me kërkesën e depozituar nga Bashkia Shkodër pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të datës 4.02.2022, ku kërkohej autorizimi për të ndryshuar vendndodhjen e 11 qendrave të votimit. Tre prej të cilave në Njësinë Administrative Shosh, tre të tjera në Njësinë Administrative Pult dhe pesë në Njësinë Administrative Shalë, sipas kërkesës që besoj tashmë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve janë njohur. Në seancën e zhvilluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kemi qenë të pranishëm. Kemi qenë kundër kësaj kërkesë dhe në përfundim është konkluduar me një pranim të pjesshëm ku dhe ju me të drejtë relatuat. Menjëherë, meqenëse dhe koha ishte e shkurtër, por dhe për shkak të rrethanave emergjente që diktojnë, ne kemi depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ankimin ku kemi parashtruar arësyet tona ku bazohet kërkesa jonë. Konkretisht së pari, ne vlerësojmë se kërkesa e datës 4 mars 2022 është e njëjtë në objekt me kërkesën e bërë në datën 28 janar 2022 për të cilën Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 116, ashtu dhe KAS-i me vendimin nr.11, datë 4 mars 2022, kishin dhënë një përgjigje të plotë dhe ezauruese duke vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Qoftë si kërkesë, qoftë dhe më pas si ankim i Bashkisë Shkodër. Pra, ne konsiderojmë se jemi në kushtet e gjësë së gjykuar, qoftë nga pozita e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ashtu dhe nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Kjo për sa i përket aspektit të parë. Aspekti i dytë i rëndësishëm, unë mendoj që për të kuptuar gjithë arësyetimin e ankimit që kemi paraqitur, duhet të ndalemi tek disa prej pikave, apo kritereve që tashmë vetë KAS-i ka vendosur duke interpretuar nenin 42 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 9 të udhëzimit nr. 1 datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator. Kodi Zgjedhor ka parashikuar shprehimisht, ndalimin e ndryshimit të qendrave të votimit në periudhën 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve. I vetmi rast kur Kodi Zgjedhor lejon ndryshimin e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.05.03.2022*

qendrës së votimit është në ato raste kur ka lindur një forcë madhore. Forca madhore – thotë më tej vendimi i marrë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, duhet të lindë pikërisht në këtë periudhë. Pra, në periudhën 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve. ashtu siç është konstatuar me të drejtë në vendimin e KAS-it, por edhe nga rrethanat e faktit, nga data 28 janar 2022 kur kryetaria e Bashkisë Shkodër, ka paraqitur listën e qendrave të votimit ku do të zhvillohej procesi i zgjedhjeve vendore të 6 marsit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në datën 4 mars, nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë. Pra, kushtet klimaterike, mundësitë e komunikacionit rrugor, apo vendbanimi i banorëve të kësaj zone nuk rezultojnë të ketë pësuar asnjë ndryshim, në mënyrë që ne sot të ishim në rrethana të reja që të mund të legjitimonin këtë kërkesë nga ana e Bashkisë Shkodër. Fakt tjetër i rëndësishëm – thotë vendimi i KAS-it dhe në vlerësimin tonë i drejtë, është fakti që gjendja madhore duhet të ketë lindur brenda territorit të qendrës së votimit dhe ndryshimi i qendrës së votimit do ta zgjidhte këtë situatë. Në fakt jemi në të njëjtat kushte si në territorin e qendrave të votimit që janë pranuar të zhvendosen nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ashtu dhe në qendrat e votimit të fshatit Theth, kushtet klimaterike janë të njëjta për shkak të afërsisë së këtyre zonave. Këtu kemi pas mundësinë të dëgjojmë dhe mendimin e inspektorit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili edhe në një e-mail të shkurtër që ka nisur thotë “e gjithë kjo zonë tashmë është e mbuluar me borë”. Pra, ndryshimi nga fshati Shalë, apo Bregu i Lumit, në fshatin Theth nuk e zgjidh atë që konsiderohet në mendimin tonë, të gabuar “forcë madhore”. Sjell në vëmendje të KAS-it një fakt që besoj të gjithë e kanë tashmë të qartë, që kemi të bëjmë si në rastin e fshatit Theth, ashtu dhe në rastin e fshatit Bregu i Lumit, apo Shalë, kemi të bëjmë me zona të thella, ku rreshjet e dëborës nuk janë forcë madhore, por janë një gjë e zakonshme në  $\frac{3}{4}$ , hiq ndoshta muajin korrik dhe gusht, gjithë periudhën tjetër të kohës atje ka rreshje dëbore. Pra, nuk është një rrethanë e cila


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

krejt papritur shfaqet në një zonë ku nuk ka rreshje dëbore. Banorët e zonës atje e kanë shumë të qartë që në këtë periudhë ka pasur zakonisht rreshje dëbore. Nga ana tjetër si me të drejtë ka parashtruar edhe KAS-i në vendimmarrjen e tij, zgjidhja se kur banorët e një zone të caktuar zgjedhin të jetojnë në një zonë tjetër, nuk është një zgjidhje që vjen nëpërmjet vendimmarrjes së KAS-it, apo vjen nëpërmjet vendimmarrjes së Komisionerit. Kjo do të duhej të rregullohej nga vetë Bashkia Shkodër. Bashkia Shkodër ka pasur afatet e nevojshme që nëse konstatonte se një pjesë e banorëve kishin pësuar lëvizje brenda territorit, mund të kërkonte ndryshimin e listës së zgjedhësve. Në këto kushte nuk jemi. Bashkia Shkodër nuk ka kërkuar që të ndryshojë listat e zgjedhësve që qytetarëve të caktuar që kanë lëvizur nga zona "A" në zonën "B" t'u mundësojë votimin. Për më tepër që ne nuk kemi asnjë fakt, asnjë dokument zyrtar, qoftë nga Bashkia Shkodër, qoftë nga ndonjë institucion tjetër që na vërteton vërtetësinë e faktit që banorët e fshatit Shalë, Bregu i Lumit, Lekaj, Nica, Pjeshollë, Ndreshaj, Lotaj, etj., kanë lëvizur nga zonat që ata banonin në qytetin e Shkodrës. Kjo nuk mund të hamendësohet, apo të merret e mirëqenë. Duhej të sillej me fakte dhe prova konkrete. Aq më tepër që është po ashtu e rëndësishme në fakt një tjetër konstatim të themi që ka bërë KAS-i, për sa i përket faktit të mungesës së infrastrukturës së pretenduar, mungesa e energjisë e pretenduar., megjithëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në seancën e datës 4 ka informuar zyrtarisht KAS-in se energjia elektrike është siguruar e plotë për të gjitha qendrat e votimit që ndodhen në fshatin Shalë dhe Bregu i Lumit. Kështu që nuk ka pasur probleme të kësaj natyre. Këto në fakt nuk mund të përbëjnë forcë madhore. Mund të konsiderohet forcë madhore mungesa e energjisë, mungesa e kushteve infrastrukturore, për më tepër që kjo ndodh prej shumë vitesh në ato zona dhe nuk është se ka lindur në këtë moment. Me të drejtë siç dhe ka rezultuar edhe në komunikimin që ne kemi pas me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. KQZ-ja kishte

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.05.03.2022*

marrë të gjitha masat e nevojshme qoftë për sigurimin e energjisë elektrike, qoftë për shpërndarjen e materialeve zgjedhore, ishin caktuar komisionerët. Edhe ne si subjekt zgjedhor i cili ka detyrimet e tij, se një pjesë e administrimit zgjedhor i është besuar partive politike, kishim marrë të gjitha masat që na takojnë. Këto kanë të bëjnë me: caktimin e komisionerëve, caktimin e vëzhguesve, sigurimin e transportit të këtyre në rastet kur ata kishin vështirësi në transport dhe mbi të gjitha që është më e rëndësishmja dhe besoj që këtu jemi të gjithë për të mbrojtur këtë interes kaq të rëndësishëm, ka të bëjë me informimin e zgjedhësit. Unë besoj se anëtarët e këtij komisioni janë njohur me fushatat informuese të KQZ-së që i kërkon zgjedhësve të informohen në lidhje me qendrën e votimit. Sot në më pak se 24-orë nga momenti që do të hapet orari zyrtar i votimit, ne ju ndryshojmë qendrën e votimit. Unë jam i bindur që një pjesë e mirë e këtyre zgjedhësve do të paraqiten te qendra e votimit ku ata kanë votuar dhe në 25 prill dhe mund të kenë verifikuar që nga momenti që janë dekretuar zgjedhjet e deri më sot dhe do të gjejnë derën e mbyllur. Do të përballemi me disa rrethana, le të themi, do t'u cënohet një e drejtë që është e rëndësishme për këta banorë. Ndërkohë, kam pas mundësinë, por sigurisht dhe për shkak të njohjes së zonës, mund të them që arësytimi që "banorët që votonin në ato qendra votimi dhe që jetojnë në fshatrat si: Mavriq, Dodaj, Mollaj, Gimaj, Lekaj, Vuksanë, Ndërhysaj, Bati, Radaj e kanë më të thjeshtë që të paraqiten në qendra votimi që i kanë 30-45 minuta larg, por të shkojnë e të votojnë në një qendër votimi që gjatë verës e kanë 2 orë, por për shkak të vështirësive të kushteve mund të shkojë dhe 3 – 4 orë? Kjo besoj se nuk ka logjikë se si të qëndrojnë. Unë mund t'u them se banorët e këtyre fshatrave që përmenda edhe në qendrën e votimit ku e kanë pasur ju duhej minimalisht 30-45 minuta, në raste të caktuara dhe një orë për të shkuar te qendra e votimit, sepse qendrat janë të grupuara. Tani të shkojnë të votojnë në Theth, kjo pothuajse është e pamundur. Siç është konstatuar edhe gjatë seancës që patëm me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*


*Dt.05.03.2022*

Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, rruga, ose aksi rrugor nga Bregu i Lumit në Theth është shumë i rënduar për shkak të rreshjeve të dëborës. Unë mendoj që një qytetar i cili jeton në fshatin Shalë ka të drejtë të votojë te qendra e votimit ku ka votuar dhe interesi i tij nuk mund të çmohet se është më pak i rëndësishëm. Apo e drejta e tij është më pak e rëndësishme se sa një banor i cili ka jetuar më parë në Shalë dhe tani jeton në Shkodër dhe i duhet të vijë të votojë dhe e ka më afër në Theth se sa atje ku është caktuar më parë qendra e votimit. Pra, qoftë për arsye ligjore, të cilat unë besoj se vendimi i KAS-it i marrë ditën e djeshme, i ka ezauruar plotësisht dhe jemi absolutisht dakord. Qoftë dhe për arsye logjistike dhe logjike, unë mendoj që vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet shfuqizuar dhe kërkesa e bërë nga Bashkia Shkodër, duhet rrëzuar për shkak se nuk vjen në përputhje me kërkesat ligjore. E ripërsëris dhe një herë, besoj se në këtë pikë edhe administrata zgjedhore mund ta ndihmojë KAS-in, sepse tashmë jam i bindur se pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë ardhur ankesat e para, qoftë nga ana e KZAZ-së, qoftë e komisionerëve lidhur me këtë ndryshim. Pra, lidhur me pamundësinë që në momentin e fundit, në këtë pak orë që ka mbetur për zgjedhjet, të bëhet gjithë spostimi si i infrastrukturës, po dhe i njerëzve për të siguruar procesin zgjedhor nga fshati Shalë në Theth, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Faleminderit avokat! Zoti Sekretar i Përgjithshëm keni diçka për të thënë në përgjigje të argumentave të paraqitur nga avokati, apo mund të kalojmë në fazën e pyetjeve, se ndoshta problemet dalin më qartë! Pyetje nga kolegët? Po zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për administratën e KQZ-së. Në lidhje me kërkesën që është bërë sot nga Bashkia Shkodër në vijim të asaj që u shqyrtua ditën e djeshme nga KAS-i. Kanë sjell ndonjë provë për faktin që banorët e këtyre qendrave të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve  
Dt.05.03.2022*

votimit *de facto* nuk jetojnë në këto zona, por jetojnë në Shkodër? Apo është i njejti argument që u përdor edhe dje?

**Z. Y. Merkaç:** Jo, është i njejti argument që u përdor edhe dje. Kemi marrë të mirëqenë faktin që e ka propozuar kryetaria e bashkisë.


**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Kam unë një pyetje, atë që avokati tha, por dhe që shihet qartësisht. Është e njejta kërkesë, për të njejtat qendra votimi që ne u shprehëm dje. Pra, kishim objekt shqyrtimi dje. Nuk e di nëse Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka administruar ndonjë provë të re që të vërtetojë që nga dje deri sot paradite ka ndryshuar, apo janë shfaqur elementë të gjendjes së jashtëzakonshme në këto fshatra, që nuk ishin dje? Pra, që dolën rishtazi tani në dukje? Ka administruar ndonjë provë që vërteton këtë situatë faktikë të forcës madhore Komisioneri? Meqenëse në vendim, miratimin e pjesshëm të kërkesës e justifikon me ekzistencën e forcës madhore, të paktën në këto pesë qendra votimi që janë transferuar.

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë, në kërkesën e parë që ka paraqitur Bashkia Shkodër “Për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit”, vendimi i Komisionerit nr. 116, në arësyetimin e tij është: Bashkia Shkodër ka paraqitur prppozim për objekte të zonës së qendrës së votimit fqinjë, apo te njësia administrative fqinjë. Kërkesë e cila bie ndesh me nenin 4...

**Z. E. Çefa:** Të lutem dhe njëherë frazën e fundit!

**Z. Y. Merkaç:** Kërkesa e parë e paraqitur nga Kryetaria e Bashkisë Shkodër “Për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit”, ka paraqitur argumentin se QV:

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.05.03.2022*


115, 116, 117, 118, 119 të cilat ndodhen në Njësinë Administrative Shalë, të transferohen në lagjen Fermentinë, në Njësinë Administrative Rrethina. Ky ka qenë argumenti dhe shkaku që ka arësytuar kryetari i bashkisë. Vendimi që ka marrë Komisioneri e ka rrëzuar për këtë shkak, duke i thënë: Bashkia Shkodër nuk ka paraqitur propozime për qendrat e votimit të zonës fqinjë, apo/por në një njësi administrative fqinjë. E cila bie ndesh me pikën 4 të nenit 93., pikën 3 të nenit 93 duhet të jetë. Sot argumenti, ose shkaku ligjor që ka paraqitur kërkesë kryetari i bashkisë ka ndryshuar në këtë shkak që ka paraqitur në kërkesën e parë. Pra, nuk jemi në të njejtin kauzus. Arësytimi i Komisionerit të vendimi nr. 128 sot është se qendrat e votimit që ka pranuar të zhvendosen QV: 116, 117, 118, 119, 119/1 janë brenda të njejtës njësi administrative, por janë zona fqinje të qendrave të votimit.

**Z. E. Çefa:** Qartë, por sipas ligjit nuk mjafton vetëm ky kusht, duhet të ketë dhe një arësye tjetër që i referohet forcës madhore, sepse jemi brenda 40-ditëshit, që kodi si rregull e ndalon lëvizjen e qendrave të votimit. Pra, duhet të ketë një justifikim më të madh që të vendoset. Komisioneri e thotë “që plotësohen kriteret e forcës madhore”. Pyetja ime ishte kjo “U administrua ndonjë dokument që të vërtetojë që atje ka ndodhur një fenomen natyror që mund të konsiderohet si forcë madhore”? Janë përmblytur këto pesë qendra votimi, a nuk e di dmth, a janë prishur? A kemi pra, një argument?

**Z. Y. Merkaç:** Jo, jo nuk ka asnjë lloj argumenti tjetër!

**Z. E. Çefa:** Dakord! Zoti Rusmali!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Komisionerit ju vu në dispozicion, e mori e konsideroi vendimin e KAS-it që u muar dje?

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. I. Rusmali:** Dhe mori vendimin pavarësisht vendimit të KAS-it?

**Z. Y. Merkaj:** Po dhe arësyetimi ishte se nuk ishte e njejta çështje, nuk ishte i njejti objekt.. jo ishte i njëjti objekt por me një shkak të ndryshëm.

**Z. I. Rusmali:** KAS-i ka argumentuar ligjërisht rrethanat kur zbatohet dispozita. Ai kishte dijeni për këtë vendim. Dakord, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Po Bashkisë Shkodër i është dërguar vendimi i KAS-it?

**Z. Y. Merkaj:** Po! Që në seancë!

**Z. L. Braho:** E gjitha duket pak si... që në seancë po, jam dakord, por arësyetimin?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk e kemi me arësyetim. Thjesht i kemi lajmëruar që KAS-i me vendimin nr. "x" ka vendosur...

**Z. I. Rusmali:** Vendimin e arësyetuar a e ka pas në dispozicion?

**Z. Y. Merkaj:** Vendimin e arësyetuar, sot e keni firmosur.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

**Z. I. Rusmali:** Dakord!

**Z. L. Braho:** Ideja është që të mos kthehet kështu si lojë kjo. Ne marrim vendim, i arësytetohet ato, se mund të ndodhë që dhe vendimmarrja tani, në varësi të vendimmarrjes, të bëhet përsëri një kërkesë nga Bashkia Shkodër. Përsëri të ketë një vendim nga Komisioneri dhe kështu futemi në një rreth vicioz që është i paqartë. Për më tepër kur nuk argumentohet se çfarë është forca madhore.

**Z. I. Rusmali:** Përfaqësuesi i ankuesit, ju gjatë shqyrtimit keni marrë në dispozicion vendimin e arësytetuar të KAS-it. E keni përdorur në argumentat tuaj këtë vendim? Keni referuar te përmbajtja e atij vendimi?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Rusmali, në fakt kemi referuar vetëm te përmbajtja e atij vendimi.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Po zoti Lako!

**Z. E. Lako:** Kam një pyetje për administratën. Në seancën e djeshme, unë bëra një pyetje. KQZ-ja, administrata mendon se mund të zhvillohen zgjedhje në këto qendra votimi që ishin objekt i vendimit të djeshëm, që është objekt dhe i këtij vendimi? Përgjigjja që mu dha ishte “Po, janë marrë të gjitha masat që në këto qendra votimi mund të zhvillohen zgjedhje”. Nga dje deri sot, çfarë ka ndryshuar që Komisioneri e quajti të arësytshme që të ndryshohet vendndodhja e këtyre QV-ve? Çfarë ka ndryshuar?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.05.03.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Thjesht ka ndryshuar kërkesa e kryetares së bashkisë, e cila ka vendosur qendra votimi alternative në fqinjë, me qendrën që do të zhvendosen dhe ka propozuar objektin konkret ku do të vendosen qendrat e votimit. Ky është argumenti!

**Z. E. Lako:** Po them shkaku? Nuk po them...

**Z. Y. Merkaj:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i gatshëm, siç e thashë edhe dje, që të hapë qendrat e votimit, të vendosë komisionerët, të vendosë fletët e votimit, vulat e të gjitha materialet zgjedhore. Këtë ka në dorë dhe ne këtë e kemi marrë përsipër dhe do t'i hapim këto qendra votimi.

**Z. E. Çefa:** Unë kam dhe një pyetje të fundit, thjesht ndoshta për t'u ashtu dhe vetë... nuk është shumë relevante në fakt për çështjen, por gjithësesi. Të gjitha këto pesë qendra votimi janë qendra kufitare me qendrën e votimit nr. 115 ku janë zhvendosur? Pra, janë kufitare nga pikëpamja gjeografike flas? Apo, janë kufitare me njëra-tjetrën?

**Z. Y. Merkaj:** Janë kufitare me njëra-tjetrën, por QV-ja nr.116 është kufitare me QV-në nr.115.

**Z. E. Çefa:** Pra, jo të gjitha këto janë kufitare me 115-tën, por vetëm një pjesë e tyre. Në rregull, nuk kam pyetje të tjera. Kolegët? Jo nuk kanë! Zoti Bele?

**Z. K. Bele:** Zoti Çefa, ju kam ndjekur! Nuk kam pyetje, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.05.03.2022*

**Z. E. Çefa:** Faleminderit ju! Besoj se u kalua kjo fazë e procesit. Formalisht mund të kalojmë në konkluzionet përfundimtare! Fjala për ju avokat!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Çefa! Siç besoj doli e qartë edhe gjatë kësaj seance. Nga dita e djeshme kur KAS-i ka marrë një vendim për këtë çështje deri ditën e sotme, nuk ka ndryshuar asgjë nga pikëpamja e rrethanave të çështjes, nga pikëpamja faktike që të bënte komisionin, apo Komisionerin të besonte se është përmbushur kushti i nenit 42 që lidhet me ekzistencën e forcës madhore. Në këtë kuptim, për ne është e qartë që në zbatim të drejtë të nenit 42 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 9 të udhëzimit nr. 1, dt. 5.12.2020 të Komisionit Rregullator, duhet shfuqizuar vendimi i Komisionerit, rrëzohet kërkesa e Bashkisë Shkodër në mënyrë që procesi zgjedhor në këto pesë qendra votimi të shkojë mbarë, ashtu si me të drejtë e relatoi Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, KAS-i do të tërhiqet për pak minuta për të marrë vendimin që do t'ua komunikojmë besoj për 15 minuta. Faleminderit, seanca deklarohet e mbyllur!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Rifillon seanca**

**Ora 17:39**

**Z. E. Çefa:** Riçelim seancën e shqyrtimit të Kërkesës Ankimore nr. 6, për të shpallur edhe vendimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Mbështetur në Kodin Zgjedhor dhe në vendimin nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, KAS-i pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi dhe vlerësoi provat vendosi:

Pranimin e kërkesës ankimore nr. 06, datë 05.03.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 128, datë 05.03.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 12/1**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

